

Informacion rreth sesionit te 34-t te UNESCO-s

Në periudhën 16 Tetor - 03 Nëntor 2007 Tetor 2007, u zhvilluan në Paris, punimet e Sesionit të 34-t të Konferencës së Përgjithshme të UNESCO-s, që mbledhet çdo dy vjet, me synimin për të përcaktuar politikat dhe drejtimet kryesore të punës së Organizatës, veçanërisht përmes shqyrtimit dhe adoptimit të programit dhe buxhetit bienal, si dhe vendimeve të tjera të rëndësishme që lidhen me fushat e kompetencës së saj.

Sesioni i 34-t u çel me zgjedhjen e George N. Anastassopoulos, Ambasador i Greqisë në UNESCO, në cilësinë e Kryetarit të Konferencës së Përgjithshme. Ai vuri në dukje, me këtë rast, se nëse UNESCO përfaqëson ndërgjegjen e njerëzimit, ajo duhet të luajë një rol aktiv, duke ruajtur njëherësh largpamësinë: "Nuk duhet të jetë thjesht një statujë, por një rojtare vigjilente. Etika e saj duhet të jetë etika e së ardhmes [...]"

Gjatë këtij Sesioni numri i shteteve anëtare të Organizatës u rrit me 2 anëtarë të rinj, si pasojë e anëtarësimit të Malit të Zi dhe rikthimit të Singaporit, duke pasur 193 shtete anëtare.

Konferenca e Përgjithshme, si organi më i lartë ekzekutiv e vendimmarrës i UNESCO-s, pati në epiqendër mbajtjen e debatit politik në datat 17-24 Tetor, sipas një kalendari të përcaktuar paraprakisht në konsultim me vendet pjesëmarrëse.

Në këtë sesion morën pjesë dhjetë Kryetarë Shtetesh e Qeverish*, ndër të cilët Presidenti Georgi Parvanov i Republikës së Bullgarisë, Mbreti Karl XVI Gustaf i Suedisë (16 October); Presidenti Karolos Papoulias i Republikës së Greqisë (18 Tetor); Presidenti Branko Crvenkovski i Republikës së Maqedonisë, Princesha Lajla Salma e Marokut, etj

Në kuadër të zhvillimit të punimeve të Sesionit të 34-t të Konferencës së Përgjithshme të UNESCO-s, Delegacioni i RSH-së u kryesua nga Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme, Znj. Edith Harxhi, e cila mori pjesë në Debatin e Politikës së Përgjithshme, në datat 18-21 Tetor.

Ne fjalën e mbajtur, gjatë këtij Debatit, në cilësinë e Kryetares së Delegacionit, Zëvendësministrja Harxhi e vuri theksin në bashkëpunimin e frytshëm dhe afatgjatë që vendi ynë ka vendosur me Organizatën, në të gjitha fushat e kompetencës. Duke vlerësuar rolin e pararojës së UNESCO-s në të mirë të progresit të gjithanshëm ekonomiko-social dhe mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, ajo nënvizoi kontributin e Qeverisë Shqiptare në realizimin e disa sfidave të rëndësishme të bashkësisë ndërkombëtare, siç janë diversiteti kulturor dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Zëvendësministrja Harxhi përshëndeti, në veçanti, aksionin e UNESCO-s, për sa i përket bashkëpunimit dhe ekspertizës efikase të Organizatës për ruajtjen dhe menaxhimin e siteve të trashëgimisë së pasur kulturore të Shqipërisë dhe ftoi strukturat e Qendrës së Trashëgimisë Botërore të japin në vazhdimësi ndihmesën e tyre për regjistrimin e ardhshëm të Beratit në Listën e Trashëgimisë Botërore.

Lidhur me bashkëpunimin rajonal në kuadër të UNESCO-s, Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme, iu referua vizionit të përbashkët të kulturës, etno-kulturës, trashëgimisë dhe diversitetit kulturor, si instrumente të mirëkuptimit dhe bashkëjetesës, pasi, siç vërejtë ajo :“atë që nuk e realizon politika e bën të mundur kultura„. Në këtë kontekst, znj. Harxhi, evokoi përpara tribunës së UNESCO-s, rëndësinë e evidentimit të trashëgimisë kulturore të Kosovës në rrugën e saj drejt pavarësisë, në përputhje me dispozitat e Planit të Ahtisarit, si një prerogativë e pajtimit dhe ndërtimit të së ardhmes së saj, në frymën e diversitetit.

Përpos Debatit Politik, gjatë Konferencës së Përgjithshme u organizuan dy Tryeza të Rrumbullakëta Ministeriale*.“Për Arsimin dhe Zhvillimin Ekonomik„, në datat 19- 21 Tetor, ku mori pjesë z. Genc Pollo, Ministër i Arsimit dhe Shkencës dhe njëkohësisht Kryetar i Komisionit Kombëtar të UNESCO-s, krahas 100 Ministrave dhe Zv.Ministrave të Arsimit të vendeve anëtare.

Pjesëmarrësit vunë në dukje angazhimin ndaj cilësisë së arsimit, përmes kurrikulave që përshtaten me nevojat e tregut global dhe ekonominë e njohjes. Theksuan rëndësinë e dialogut ndërkombëtar “për t’iu kundërvënë impaktit negativ të “brain drain” dhe inkurajuan partneritetet publike-private, me qëllimin ndërtimin “e urave efikase ndërmjet arsimit dhe botës së punës”. Më tej, Ministrat ranë dakort se arsimi për zhvillimin e qëndrueshëm duhet të integrohet në të gjitha nivelit e mësimit, formal dhe jo-formal. Tryeza e dytë- “Shkenca dhe teknologjia për zhvillimin e qëndrueshëm dhe roli i UNESCO-s” – u zhvillua në datat 26- 29 Tetor, ku mori pjesë ZëvendësMinistrja Adriana Gjonaj, krahas 48 Ministrave të Arsimit dhe 25 Zv.ministrave. Pjesëmarrësit iu përmbajtën në qëndrimet e tyre nevojës për nxitjen e arsimit shkencor dhe zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Koichiro Matsuura, Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s i vlerësoi maksimalisht rezultatet e diskutimeve gjatë dy Tryezave. Në fjalën përmblylëse, ai u shpreh se, “E drejta për arsimim nuk mund të përmbushet, nëse mbizotëron varfëria.”, “kësisoj, ndërkohë që arsimi education është një mjet për nxitjen e zhvillimit ekonomik, e kundërta është po kaq e vërtetë. Një bazë ekonomike në rritje zgjeron mundësinë the possibility e të ardhurave më të mëdha nga taksat dhe, në këtë mënyrë aftëson qeveritë për të siguruar investime në arsim....Kështu, mund të vendoset një qark i mundshëm për progres.”

Gjatë punimeve të Konferencës së Përgjithshme, u mblodhën në Sesione të posaçme disa Komitete Ndërqeveritare, që kanë një peshë specifike për vendimmarrjen dhe implementimin e objektivave të UNESCO-s, për të ardhmen afat-mesme.

Mbajtja e punimeve të këtyre Komiteteve pati rëndësi edhe për ecurinë e disa dosjeve të rëndësishme që pala jonë ka në proces me Organizatën.

Kësisoj, më datë 24 Tetor, Shqipëria u zgjodh, për herë të parë, pas 49 vjet marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi me Organizatën dhe pas disa herësh të përsëritura kandidimi, anëtare e Këshillit Ekzekutiv, duke marrë 157 vota.

Ndër 31 vendet e tjera fituese në këtë Këshill, figurojnë me mandate përfaqësimi Franca, Gjermania, Italia, Greqia, Bullgaria, Hungaria, Spanja, Shtetet e Bashkuara dhe Federata Ruse, si dhe disa vende të tjera të rajonit të Azi-Paqësorit dhe Amerikës Latine.

Këshilli Ekzekutiv është organi më i rëndësishëm vendimmarrës i UNESCO-s që vëzhgon nga afër përpilimin dhe zbatimin e Strategjive afat-shkurtra dhe afat-mesme të Organizatës, përcakton politikat e bashkëpunimit me 193 vendet anëtare, me organizmat ndërkombëtare dhe sektorin e shoqërisë civile. Këshilli Ekzekutiv ka gjithashtu si funksion pjesëmarrjen dhe vënien në zbatim të reformës së Kombeve të Bashkuara, në kontekstin e fushave të kompetencës së UNESCO-s, në cilësinë e saj si agjenci e specializuar e sistemit të OKB-së. Gjatë mandatit në vazhdim, Këshilli Ekzekutiv do të zgjedhë edhe Drejtorin e Përgjithshëm të UNESCO-s.

Ne zgjedhjet e zhvilluara gjatë këtij Sesioni të Konferencës së Përgjithshme, Shqipëria renditet ndër 58 vendet anëtare të Këshillit, duke rritur kështu shkallën e pjesëmarrjes dhe të kontributit të saj aktiv në debatet dhe politikat e sotme të Organizatës, të orientuara për nga ndërtimi i paqes, pluralizmit kulturor dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Në datat 24-25 tetor, u mbledh Asambleja e 16-të e Shteteve palë në Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore, që zgjodhi anëtarët e rinj të Komitetit të Trashëgimisë Botërore. Ky organ i fundit, siç e dëshmoi edhe Mbledhja e Zelandës së Re, do të ketë rëndësi jetike për regjistrimin e mundshëm të Beratit si trashëgimi në seri me Gjirokastrën, në Listën e Trashëgimisë Botërore, në Mbledhjes së Kanadasë, gjatë vitit në vijim.

Një tjetër Komitet i rëndësishëm për bashkëpunimin tonë është edhe Komiteti Ndërqeveritar për Edukimin Fizik dhe Sportin, (CIGEPS), ku Shqipëria është zgjedhur me një mandat përfaqësimi, ndër 18 vendet e tjera të pranishme.

Sipas praktikës në fuqi, Sekretariati i UNESCO-s thërret gjatë çdo Konferencë të Përgjithshme, pesë mbledhje rajonale për Komisionet Kombëtare të UNESCO-s, me qëllim planifikimin e veprimtarive të këtyre Komisioneve për dyvjeçarën 2008-2009, si dhe për të debatuar problematikën e përgjithshme të punës së tyre. Mbledhja e Komisioneve të rajonit të Europës dhe Amerikës së Veriut, ku bën pjesë edhe Shqipëria, u zhvillua më datë 24 Tetor.

Kjo Konferencë pati rëndësi të veçantë edhe për faktin se, në cilësinë e organit më të lartë vendimmarrës të UNESCO-s, mori në shqyrtim dhe miratoi Strategjinë Afat-Mesme për periudhën 2008-2013.

Strategjia parashtron pesë përparësi: Arritja e një arsimimi cilësor gjatë gjithë jetës dhe për të gjithë; mobilizimi i njohurive shkencore dhe politikave për zhvillim të qëndrueshëm; zgjedhja e sfidave të reja etike; nxitja e diversitetit kulturor dhe dialogut ndërkulturor; si dhe ndërtimi i shoqërive gjithëpërfshirëse të njohjes përmes informimit dhe komunikimit. Përgjatë kësaj peirudhe, Afrika dhe barazia gjinore do të përbëjnë gjithashtu përparësi për Organizatën në të gjitha fushat e veta të kompetencës, si dhe aktivitetet specifike në favor të rinisë, të vendeve në zhvillim dhe Ishujve të vegjël në zhvillim.

Për sa i përket dyvjeçarit 2008-2009, Konferenca e Përgjithshme adoptoi propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm për një buxhet prej US\$ 631 milionë, që përfaqëson një rritje me 3.4% në krahasim me dyvjeçarin e kaluar. Arsimi mbeti sërish përparësi mbi përparësitë me shumën e alokuar US\$108.4 milionë. Shkencat natyrore US\$ 56 milionë, shkencat shoqërore US\$ 29.1 milionë. Sektori i Kulturës US\$ 51.3 milionë, ndërsa ai i komunikim-informacionit US\$ 32 milionë.

Vlen të shënojmë ndër vendimet më të rëndësishme të marra gjatë këtij sesioni,: për fushën e arsimit, Inisiativa për Trajnimin e Mësuesve në Afrikën nënsahariane (TTISSA), nxitja e mëtejshme e Dhjetëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara për Arsimin në të mirë të zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbajtja, në këtë sens, e Konferencës Botërore për Arsimin e Lartë +10 në vitin 2009. Për sa u përket shkencave, Konferenca e Përgjithshme e vuri theksin tek aspirata për të fuqizuar veprimtaritë e Komisionit Ndërqeveritar Oqeanografik, i cili përgjigjet për sistemet e sinjalizimit të hershëm të cunamëve, duke vendosur gjithashtu për krijimin e qendrave të tjera, që kanë të bëjnë përkatësisht me ujin, zhvillimin e burimeve të qëndrueshme energjitike, dhe kërkimet për karst

Për shkencat shoqërore dhe njerëzore, Konferenca e Përgjithshme miratoi ngritjen në Greqi të një Observatori për Gratë, Sportin dhe Edukimin Fizik, si dhe kërkoi më shumë fizibilitet për krijimin, në Buenos Aires, të një Instituti Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut në Arsim, dhe i dha gjithashtu mbështetje festimeve të ardhshme të 60 Vjetorit të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

Për kulturën, theksi u vu në përmirësimin e administrimit të Qendrës së Trashëgimisë Botërore dhe thellimit të luftës kundër trafikut të paligjshëm të objekteve kulturore. Ndër çështjet e tjera që u morën në diskutim ishin: krijimi i një qendre rajonale për arkeologjinë nënjore në Zadar (Kroaci), ngritja e një instituti të trajnimit dhe kërkimit shkencor mbi trashëgiminë botërore për rajonin e Azi-Paqësorit (Kinë), dhe nisja e një studimi fisibiliteti për një Institut të Kulturës Afrikane dhe Mirëkuptimit Ndërkombëtar në Abeokuta (Nigeri).

Për komunikim-informimin, Konferenca e përgjithshme miratoi propozimin e Bahreinit për të ngritur një qendër rajonale për teknologjitë e informacionit, nën exhidën e UNESCO-s, që do të vendoset në Manana dhe do të jetë e para qendër e këtij lloji. Konferenca i dha gjithashtu mbështetje veprimtarive ndërsektoriale, përkatësisht përdorimit të teknologjive të informacionit, në arsim dhe në shkencat shoqërore.

Më tej, Konferenca i kërkoi, përmes një Rezolutive Drejtorit të Përgjithshëm një rol më të spikatur të UNESCO-s në veprimtaritë që synojnë ruajtjen e memories së Holokaustit, nëpërmjet arsimit, por edhe parandalimin e të gjitha formave që e mohojnë atë. Shqipëria u rendit ndër vendet bashkësponsorizuese të kësaj Rezolutive.